**SHOQERIA TREGTARE**
**Me përgjegjësi të kufizuar**
**" TTA BEAUTY" Sh.p.k**
**TIRANE**

# AKT - THEMELIMI

Në Tiranë, sot më datën 11.10.2022 (dymije e njëzetë e dy), ne shtetasit:

**Elton Stërmasi**, shtetas shqiptar, lindur më 12.07.19699 në Tiranë, banues në Tiranë, Rr. »R. Çollaku », Pall. Shallvare, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Letër Njoftimi ID Nr.Personal G90330164B.

**Mirseida Musaj**, shtetase shqiptare, lindur më 14.09.1982 në Elbasan, banuese në Tiranë, Rr. »Muzakët », madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Letër Njoftimi ID Nr.Personal I25914133M.

**Rozeta Fataj,** lindur më 15.02.1982 në Vlorë, banuese në Tiranë, Rr. »Vorpsi », Pranë Njësisë Bashkiake Nr.13, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Letër Njoftimi ID Nr.Personal I25215199M.

Me Vullnet të lirë e të plotë dhe inisiativën e lirë private, mbështetur :

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,
Në ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, " Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare ", **krijojmë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar "TTA BEAUTY" Sh.p.k.**

## NENI 1
## EMERTIMI

Shoqëria tregtare, formohet nga dy Ortakët e sipërcituar, dhe emërtohet **"TTA BEAUTY" Sh.p.k,** emërtimi i së cilës do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

## NENI 2
## SELIA

**Selia e shoqërisë "TTA BEAUTY" Sh.p.k është në Tiranë, Rr." Reshit Çollaku", Pall. Shallvare, Shk.18, Ap.261.**

## NENI 3

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit.
Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, mund të krijohen ose anullohen (në rast se janë çelur), seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj. Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë si Degë apo përfaqësi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vëndeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vëndeve të ndryshme.

## NENI 4

**KAPITALI I REGJISTRUAR**

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 12000 (dymbëdhjetë mijë) lekë, formuar dhe nënshkruar nga Ortakët e shoqërisë i ndarë në 3 (tre) kuota kapital që paguhet në para nga ortakët.

**Elton Stërmasi, zotërues i 1 (një) kuote të kapitalit me vlerë nominale 4080 lekë, që përfaqëson 34 % (tridhjetë e katër) të kapitalit.**

**Mirseida Musaj, zotëruese e 1 (një) kuote të kapitalit me vlerë nominale 3960 lekë, që përfaqëson 33 % (tridhjetë e tre) të kapitalit.**

**Rozeta Fataj, zotëruese e 1 (një) kuote të kapitalit me vlerë nominale 3960 lekë, që përfaqëson 33 % (tridhjetë e tre) të kapitalit.**

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi Jdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi pdo lloj pasurie tjetër të fituar në mige të ligjshme.
Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

**NENI 5**

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë, bëhet para kërkesës së drejtuar QKR për njohjen dhe rregjistrimin e saj si person juridik.

**NENI 6**

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është mbi 10 vjet, duke filluar ky afat nga dita e shpalljes së regjistrimit pranë QKB Tiranë, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.
Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky vendim i dërgohet mënjeherë për depozitim QKB për të bërë shënimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

NENI 7

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

**NENI 8**

Shoqëria çelllogari bankare në lekë vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.
Ortakët dhe administratori i caktuar prej saj, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre orgjinale në Bankat ku është çelur llogaria.

**NENI 9**

Pjesët e kapitalit themelor, janë lirisht të tmnsferueshme në migë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atij Tregtar.
Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të transferojnë pjesërisht apo tërësisht kontributet e tyre përfshirë dhe fondet e Kontributet në natyrë.
Transferimet e pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jenë të vertetuara me akt noterial dhe për një gjë të tillë Ortakët duhet të marrin paraprakisht vendim me shkrim.
Shoqëria dhe të tretet duhet të respektojnë këto transferime sapo tu bëhen të ditura.

NENI 10

**Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare "TTA BEAUTY" Sh.p.k është:**

- Tregtim me pakicë dhe shumicë Import-eksport, shitje me pakicë dhe shumicë të produkteve kozmetike.
- Tregtimi me pakicë dhe shumicë, Import-Eksport të artikujve të ndryshëm industrial, konfeksione, elektroshtëpijake, në fushën e turizmit si agjensi turistike, në fushën e telekomunikacionit, bar-restorant, importimin dhe eksportimin e mallrave industrial e ushqimore, elektroshtëpijake. Veprimtari tregtare në fushën e ushqimit social, hotelere etj.
- Tregti Import-Eksport, me shumicë e pakicë të artikujve të konsumit të gjë0072ë e ato ushqimore e blegtorale.

**Gjithashtu shoqëria ka si objekt plotësues të veprimtarisë së saj edhe:**

Operacione tregtare e komisionerie dhe transaksione të ndryshme të çdo lloj malli.
Tregtim artikuj luksi, artikuj bukurie, organizim menaxhim salon bukurie, flori, orë, bizhuteri.
Agjensi stili, mode, agjensi menaxhimi të drejtash modelesh, sportistësh. Profesioniste ose subjekte juridike, ndërmjetësim në shitje-blerje të drejtash.
Përfaqësim të së drejtave televizive të subjekteve dhe individë.
Organizim Radio – TV-Shtyp periodic, të përditshëm, botim.
Organizim zyre juridike, konsulence, arkitekture, menaxhim biznesi, ekonomike, kambizëm.

**Shoqëria mund të kryejë aktivitete të tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm për qëllimin shoqëror.**

Dhënjen e makinave, motorëve, minibuse, autobuse dhe të gjitha mjetet e tjera motorike me qira personave të tretë, për çdo mjet të lëvizshëm të lejuar për qarkullim, shërbim taksi, shërbim urban, interurban, ndërkombëtar, ndërkontinental etj.
Transport udhëtarësh e mallrash, kombëtar e ndërkombëtar, cargo etj.
Krijimi i agjencive turistike, organizimi i guidave turistike Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për të realizuar objektin e saj shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditimi ashtu si dhe administrimi, si edhe të blejë dhe të shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë interesa ose pjesmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipës, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Më në përgjithësi shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

**NENI 11.**

Ortaket mund të zgjerojnë aktivitetin tregtar të shoqërise dhe në drejtime të tjera , të cilat janë me interes për mbarëvajtjen e shoqerisë.

**NENI 12**

Ortakët mund të zgjerojnë shoqërinë duke pranuar një ose me shumë ortak♪7 të tjerë, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqeri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

**NENI 13**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që parashikon ligji "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare ".

Ortakët mund t'ia delegojnë kompetencat e tyre një ose më shumë administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës.

**NENI 14**

**Adminsitrator i shoqërisë " TTA BEAUTY" Sh.p.k është z. Elton Stërmasi, me afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë ripërtëritje.**

**NENI 15**

Ky Akt Themelimi u redaktua ne 4 ekzemplarë, vetëm në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike dhe i nënshkruar nga Ortakë e shoqërisë.

**THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE**
**" TTA BEAUTY" Sh.p.k**

Rozeta Fotaj

Elton Stërmasi

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER ILIR QEJVANI**

V2022054220235349683

**DATE 17/10/2022**
**NR REP 2713**

# VËRTETIM NËNSHKRIMI

Në Tiranë, sot më datë 17.10.2022 (dy mijë e njëzetë e dy), **para meje Noter Ilir Qejvani, anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë,** me zyrë në adresën Tiranë, Njësia Administrative Nr.10, Tiranë, Rr."M.Shyri", Pall.44/1/1, u paraqitën personalisht:

**DEKLARUESIT**:

**Elton Stërmasi,** atësia Sirri, amësia Myzejen, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr."Reshit Çollaku"; Nd. Shallvare; H. 18; Ap. 261; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 30/03/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga Letërnjoftimi ID nr. 034461404 dhe nr. personal G90330164B.

**Mirseida Musaj,** atësia Tomorr, amësia Lavdije, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr."Muzakët"; Nd. 27; H. 2; Ap. 29; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 14/09/1982, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova nga Letërnjoftimi ID nr. 037193809 dhe nr. personal I25914133M.

**Rozeta Fataj,** atësia Qerem, amësia Vitore, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr."Vorbsi" 03910146; Nd. 1; H. 1; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 15/02/1982, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova nga Letërnjoftimi ID nr. 035955885 dhe nr. personal I25215199M.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan para meje noterit, Aktin e Themelimit të shoqërisë "TTA BEAUTY" Sh.p.k.

Unë noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERI**

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE